



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 971 / prot.  
3

Tiranë më 27.7.2018

**VENDIM**

Nr. 44, datë 27.7.2018

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesi, Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Z. \_\_\_\_\_ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 971 Prot., datë 01.06.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me shkresën e datës 26.04.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm lidhur me:

1. *A ka detyrime të papaguara nga ana e kompanisë Ionian Refining and Trading Company - IRTC?*
2. *Çfarë masash/vendime janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për detyrimet e papaguara nga kompania Ionian Refining and Trading Company - IRTC?*
3. *Na vini në dispozicion një kopje të masave/vendimeve të marra për këtë subjekt.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 971 Prot., datë 01.06.2018 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e

informimit” në të cilin citohet se *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, me shkresën nr. 971/1 Prot., datë 09.07.2018, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 17.07.2018 në mungesë të ankuesit dhe me praninë e përfaqësuesve të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës, Koordinatorja për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik sqaroi se, me shkresën nr. 8959/1 Prot., datë 29.06.2018 i është kthyer përgjigje kërkuarit duke i bërë me dije se: *“Për tatimpaguesin “Ionian Refining and Trading Company – IRTC” janë marrë të gjitha masat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, të kërkuara nga Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar”,* çka nënkupton gjithashtu se subjekti në fjalë ka detyrime të paguara.

Pas zhvillimit të seancës, me shkresën nr. 15222 Prot., datë 24.07.2018, Autoriteti Publik ka informuar Komisionerin mbi veprimet procedurale të ndjekura lidhur me kërkesën e Qendrës “Res Publica”, ku ndër të tjera sqaron se: *“Kërkuarit i janë vënë në dispozicion të dhëna të përgjithshme, ndërsa lidhur me vlerën e detyrimeve dhe të dhëna të tjera konfidenciale, e drejta e informimit kufizohet nga detyrimi ligjor i organit administrativ për të ruajtur konfidencialitetin e të dhënave tregtare dhe tatimore të tatimpaguesit, parashikuar këto në nenet 24, 25 dhe 31 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar dhe nenit 17 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”*.

Pas shqyrtimit të ankimit dhe konsultimit të legjisllacionit përkatës rezulton se, jashtë afatit të përcaktuar në nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Autoriteti Publik i ka kthyer përgjigje pjesërisht kërkuarit, vetëm për pikën e parë të objektit të kërkesës, duke mos përmbushur në tërësi objektin e kërkesës. Komisioneri vëren se në përgjigjen e dërguar kërkuarit, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar në mënyrë të drejtë arsyet e mosvënies në dispozicion të informacionit të kërkuar në pikën e dytë dhe të tretë të objektit të kërkesës.

Komisioneri vlerëson se refuzimi i dhënies së informacionit mbi bazën e nenit 24 të ligjit “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, është i gabuar pasi sipas qëndrimit të mbajtur nga Autoriteti Publik, aksesit në informacionin e disponuar nga autoritetet tatimore iu legjitimohet vetëm institucioneve të përmendura në të, duke përjashtuar *a priori* çdo individ që kërkon akses sipas dispozitave të Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Dispozita në fjalë parashikon autoritetet të cilëve iu ofrohet pa pagesë informacioni tatimor në lidhje me një tatimpagues të caktuar, por nuk parashikon ndalimin e dhënies së informacionit tatimor për subjekte të tjera mbi bazën e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Qëllimi i nenit 24 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk është përjashtimi i subjekteve të përmendura në të nga aksesit në informacionin e administruar nga administrata tatimore, por thjeshtimi i marrëdhënieve dhe komunikimit midis administratës tatimore me këto institucione, eficaenca dhe deburokratizimi i administratës

publike, si dhe ekonomia gjyqësore. Gjithashtu dispozitat e nenit 24 janë të zbatueshme dhe për ato raste kur informacioni nuk përbën informacion publik në kuptim të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe dhënia e tij kryhet në një kontekst të caktuar siç është rasti i një procesi gjyqësor civil apo penal, kontrolli i ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në kuadër të veprimtarisë së tij, etj.

Lidhur me kufizimin e parashikuar në nenin 25 të ligjit të sipërcituar, në të cilën parashikohet: *Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore dhe vendore ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës. Kjo pikë nuk zbatohet për detyrimet tatimore, për të cilat kanë filluar procedurat e mbledhjes me forcë*, Komisioneri vlerëson se, dispozita është vetëshpjeguese përderisa ndaj subjektit të kërkuar ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve të pashlyera.

Gjithashtu, Komisioneri e vlerëson argumentin e Autoritetit Publik se refuzimi i dhënies së informacionit bazohet në nenin 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" të gabuar dhe të pambështetur në ligj. Kjo pasi neni 17 i këtij ligji liston qartë rastet kur dhënia e informacionit mund kufizohet dhe në vlerësimin e Komisionerit, rasti konkret nuk mund të kategorizohet si subjekt i asnjë prej kufizimeve të parashikuara në nenin 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "*informacion publik*" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik". Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

Qëndrimi i mësipërm është i përsëritur nga administrata tatimore edhe pse Komisioneri është shprehur më parë me vendim për rast të përafërt.

Nga thëniet e Koordinatorës për të Drejtën e Informimit gjatë seancës dëgjimore Komisioneri konstatoi se kjo e fundit i ka përmbushur detyrimet e parashikuara nga Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Me qëllim identifikimin e personit përgjegjës që është bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit, Komisioneri kërkoi nga Autoriteti Publik korrespondencën e brendshme lidhur me trajtimin e kërkesës për informacion. Nga dokumentacioni i depozituar në përgjigje të kësaj kërkesë, Komisioneri vëren se pasi kërkesa për informacion është depozituar pranë Autoritetit Publik, Koordinatorja për të Drejtën e Informimit e ka përcjellë atë pranë Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë të Detyrimeve. Nga sa pasqyrohet në korrespondencën e administruar nga Komisioneri, kjo drejtori ka përgatitur informacionin e kërkuar dhe ia ka përcjellë Koordinatorës me sqarimin se përcjellja e mëtejshme e informacionit tek kërkuesi mbetet në shqyrtim të Drejtorisë Ligjore dhe Teknike. Koordinatorja e ka përcjellë informacionin për mendim tek Drejtoria Ligjore dhe Teknike dhe kjo e fundit është shprehur se: "*Sikundër ju kemi*

*sqaruar në vazhdimësi, informacioni i përcjellë në kuadër të të drejtës për informim nuk duhet të përmbajë vlera konfidenciale të detyrimeve të subjektit.”*

Nga sa më sipër Komisioneri konstaton se qëndrimi i mbajtur nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike përputhet me atë të mbajtur nga administrata tatimore në vazhdimësi. Titullarja e drejtorisë në fjalë ishte e pranishme edhe gjatë seancës dëgjimore ku e konfirmoi këtë qëndrim. Në këtë mënyrë Komisioneri konstaton marrjen nga ana e saj të një roli aktiv në moszbardhjen e informacionit, duke penguar kështu ushtrimin e të drejtës për informim të garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji i posaçëm mbi të drejtën e informimit.

Në rastin konkret jemi përpara tejkalimit të afatit të parashikuar nga ligji për vënien në dispozicion të informacionit, (afat i cili sipas nenit 15 të tij është 10 ditë punë), si dhe para refuzimit aktiv të vënies në dispozicion të informacionit.

Bazuar në nenin 18, pika 2. II) e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ky qëndrim përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 150 000 deri në 300 000 lekë.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në shkronjën II) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 4 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, i ndryshuar,

### **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankimit nr. 971 Prot., datë 01.06.2018 të Qendrës “Res Publica”, përfaqësuar nga Z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, dhe më konkretisht: 1. A ka detyrime të papaguara nga ana e kompanisë *Ionian Refining and Trading Company - IRTC*? 2. Çfarë masash/vendime janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për detyrimet e papaguara nga kompania *Ionian Refining and Trading Company - IRTC*? 3. Na vini



në dispozicion një kopje të masave/vendimeve të marra për këtë subjekt, brenda datës 06.8.2018.

3. Dënimin e Drejtorit të Drejtorisë Ligjore dhe Teknike pranë Autoritetit Publik, Znj. Ilda Koja, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 4. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
6. Ky vendim u shpall sot në datë 27.7.2018.

